



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



# KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

## Grupi i Punës për Kapitullin 24 – Forcimi i kapaciteteve ligjzbatuese përmes arsimit policor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar: roli i Akademisë së Sigurisë në procesin e integrimit evropian

07 prill 2026

Xheko Imperial Hotel

11:00 - 12:30

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë, ka kënaqësinë t'ju ftojë në takim të radhës të Grupit të Punës për Kapitullin 24 – Drejtësia, Liria dhe Siguria, të organizuar në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Evropian, me mbështetjen e Bashkimit Evropian.

Ky takim do të fokusohet në rolin e Akademisë së Sigurisë në forcimin e kapaciteteve të strukturave ligjzbatuese, si dhe në rëndësinë e arsimit, trajnimit profesional dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në funksion të përmbushjes së standardeve të Bashkimit Evropian në fushën e sigurisë.

Grupi i Punës për Kapitullin 24 ofron një hapësirë për konsultim dhe dialog, duke mundësuar përfshirjen aktive të aktorëve jo-shtetërorë në procesin e negociatave me BE-në, si përfaqësues nga shoqëria civile, akademja, profesionistë të ligjit dhe grupe të tjera interesi. Sesioni synon jo vetëm të informojë rreth procesit legjislativ, por edhe të sigurojë që shoqëria civile, akademja dhe grupet e interesit të japin rekomandime, të ofrojnë reagime mbi kuadrin ligjor dhe të monitorojnë në mënyrë aktive hartimin e politikave në të gjitha fazat.

Diskutimi do të trajtojë zhvillimet më të fundit në lidhje me kurrikulën, trajnimet dhe ngritjen e kapaciteteve të forcave ligjzbatuese në Shqipëri, duke u fokusuar te mundësitë për bashkëpunim, por edhe te sfidat që hasen në këtë drejtim, si dhe duke identifikuar mundësi konkrete për zhvillim dhe përmirësim të mëtejshëm. Në këtë takim do të kontribuojnë Rektori i Akademisë së Sigurisë në Shqipëri, si dhe zëvendës Rektori i Akademisë homologe në Sllovaki, të cilët do të ndajnë përvojat e tyre mbi organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e institucioneve të arsimit policor, me fokus në ndërtimin e kapaciteteve, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe përafrimin me standardet e BE-së.

Mirëpresim pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj në këtë tryezë diskutimi  
Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në: [info@em-al.org](mailto:info@em-al.org)

Kjo tryezë për GP - Kapitulli 24 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).





Financuar nga  
Bashkimi Evropian



# KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

## Grupi i Punës për Kapitullin 24 – Forcimi i kapaciteteve ligjzbatuese përmes arsimit policor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar: roli i Akademisë së Sigurisë në procesin e integrimit evropian

07 prill 2026

Xheko Imperial Hotel

11:00 - 12:30

10:30 – 11:00

REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE DHE KAFE

11:00 – 11:30

FJALA HAPËSE

**Gledis Gjipali**, Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

ZHVILLIMET KRYESORE, SFIDAT DHE MUNDËSITË PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE LIGJZBATUESE NË SHQIPËRI – ROLI I AKADEMISË SË SIGURISË

- Historik i Akademisë së Sigurisë – Vizioni dhe Misioni
- Arritjet kryesore ndër vite në kuadër standardet e BE
- Bashkëpunimi me BE/CEPOL dhe akademitë e vendeve anëtare
- Rekomandime për fushat e nevojshme për më shumë përpjekje dhe prioritizim

**Prof. Dr. Ilirjan Mandro**, Rektor i Akademisë së Sigurisë në Shqipëri

11:30 – 12:00

EKSPERIENCA SLOVAKE DHE STANDARDET EUROPIANE NË ARSIMIN POLICOR

- Standardet europiane për formimin e forcave ligjzbatuese profesionale, me integritet dhe efektivitet
- Bashkëpunimi me institucionet publike, përfshirja e aktorëve jo-shtetërorë dhe praktikat pozitive
- Mundësitë në nivel evropian për bashkëpunim me CEPOL dhe agjencitë e tjera
- Rekomandime për fushat më sfiduese dhe parapërgatitja për të shmangur problematikat

**Dr. Jozef Medelský**, Zëv. Rektor për mësimdhënien, Akademia e Sigurisë e Sllovakisë

12:00 – 12:30

DISKUTIM I HAPUR

12:30

MBYLLJA E AKTIVITETIT DHE DREKË KOKTEJL

Kjo tryezë për GP - Kapitulli 24 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).

